

LIGJI NR. 08/L-052**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 05/L-010 PËR
AGJENCINË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS****Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 05/L-010 PËR
AGJENCINË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS****Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Neni 2

Neni i 2 i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj ka për qëllim krahasimin, verifikimin dhe zgjidhjen e mospërputhjeve në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën e bashkësive fetare; zgjidhjen e kërkesave të mbetura lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale; si dhe njohjen dhe formalizimin e të drejtave pronësore të pakontestuar dhe legjitime të bartura në mënyrë joformale ndërmjet palëve para 24 marsit 1999, aktualisht të ushtruara sipas ligjeve të Kosovës.

Neni 3

Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1, shtohen nën paragrafët e rinj 1.6, 1.7 dhe 1.8 ndërsa nën paragrafi 1.6 i ligjit bazik zëvendësohet dhe merr numrin 1.9 me tekstin si në vijim:

1.6. **KKPB** - Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore;

1.7. **Mospërputhje** - rastet kur në dokumentet kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe dokumentet kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, kanë ndryshime përmbajtjesore të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në të drejtat pronësore apo titullarin e pronës;

1.8. **Zbrazëti** - rastet kur dokumentet kadastrale origjinale, të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe dokumentet kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, kanë ndonjë zbrazëti teknike dhe jo-substanciale, zbrazëti e cila nuk ndikon në asnjë mënyrë në të drejtat pronësore apo në titullarin e pronës dhe që janë teknikisht të korrigjueshme;

1.9. Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare - Ligji në fuqi për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian që i referohet emërimit të anëtarëve ndërkombëtarë të organeve të AKKVP-së.

Neni 4

Neni 4 i ligjit bazik, plotësohet dhe ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

1. AKKVP është institucion i pavarur i themeluar sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

2. Përgjegjësitë e AKKVP-së janë:

2.1. Pranon, krahason, verifikon dhe përmes KVVP-së, zgjidhë zbrazëtitë dhe mospërputhshmëritë në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të para qershorit të vitit 1999, të cilat janë marrë në Kosovë nga autoritetet serbe dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën e bashkësive fetare.

2.2. Përmes KKP-së, do të vazhdojë të rishqyrtojë kategoritë vijuese të kërkesave të parashtruara, gjatë mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës, e që janë të lidhura me luftën në Kosovë, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to, ose janë pasojë e saj, në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:

2.2.1. Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale;

2.2.2. Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale;

2.3. Pranon, shqyrton dhe përmes KKP- së vendos për kërkesat e parashtruara për njohje ligjore të të drejtave pronësore, të pakontestuar dhe legjitime, mbi pronat e paluajtshme, të bartura përmes transaksioneve joformale para 24 marsit 1999, bartja formale e të cilave është ndaluar nga legjislacioni diskriminues apo për të cilat dokumentet e kërkuara për regjistrim në sistemin kadastral të Kosovës nuk ekzistojnë;

2.4. Të zbatojë vendimet e KKPB, KKP dhe KVVP;

2.5. Të administrojë pronat me kërkesën e parashtruesit të suksesshëm të kërkesës;

2.6. Të zbatojë skemën vullnetare të qirasë për pronat nën administrim të AKKVP-së.

Neni 5

Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1 riformulohet, ndërsa shtohen dy paragrafë të rinj 3 dhe 4 me tekstin si në vijim:

1. KKP është organ i pavarur, i mandatuar që të vazhdojë të vendosë kërkesat e mbetura të paraqitura në Agjencinë Kosovare për Prona, lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale; si dhe vendosë kërkesat e paraqitura për njohje ligjore të të drejtave joformale pronësore, të pakontestuar dhe

legjitime, për pronën e paluajtshme, të bartura ndërmjet palëve përmes transaksioneve joformale para 24 marsit 1999, bartja formale e të cilave është ndaluar nga legjislacioni diskriminues apo për të cilat dokumentet e kërkuara për regjistrim në sistemin kadastral të Kosovës nuk ekzistojnë.

3. Lartësinë e kompensimit të anëtarëve të Komisionit e përcakton Institucioni i cili i emëron.

4. Anëtarët e KKP të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet të kenë reputacion të lartë profesional dhe integritet të lartë personal si dhe të kenë përvojë pune së paku prej pesë (5) viteve në fushën të drejtave pronësore.

Neni 6

Neni 9 të ligjit bazik, i shtohen tre paragrafë të rinj 3, 4 dhe 5 me tekstin si në vijim:

3. KVVP është organ i pavarur i mandatuar që të shqyrtojë dhe vendos rastet e referuara nga ana e Sekretarisë lidhur me zbrazëtitë dhe mospërputhjet në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, dhe pronën e bashkësive fetare.

4. Lartësinë e kompensimit të anëtarëve të KVVP-së e përcakton institucioni i cili i emëron.

5. Anëtarët e KVVP të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet të kenë reputacion të lartë profesional dhe integritet të lartë personal si dhe të kenë përvojë pune së paku prej pesë (5) viteve në fushën të drejtave pronësore.

Neni 7

Pas nenit 11 të ligjit bazik shtohet nje neni i ri 11A me tekstin si në vijim:

Neni 11A

Procedura për përpunimin e kërkesave për njohje ligjore të të drejtave joformale pronësore

1. Kërkesat për njohje ligjore të të drejtave joformale pronësore parashtrohen në Sekretari brenda tre (3) vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Sekretaria njofton dhe dërgon një kopje të kërkesës tek të gjitha palët e njohura me interes në pronën që është subjekt i kërkesës dhe bënë çdo përpjekje për të njoftuar të gjitha palët me interes duke bërë njoftim publik për kërkesën e parashtruar. Për njoftimin e palëve me interes, AKKVP shfrytëzon platformën elektronike për njoftim, Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe publikimin në mediat e shkruara apo elektronike. Procedurat e njoftimit dhe informimit të palëve përcaktohen me akt nënligjor.

3. Çdo person, përveç parashtruesit të kërkesës, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën që është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesa është palë në këtë kërkesë, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurë brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria.

4. Përgjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, çdo person i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën, por i cili nuk i është përgjigjur njoftimit mbi kërkesën, pranohet si palë në procedurë brenda një (1) viti nga publikimi i kërkesës.

5. Palët e interesuara mund t'i dorëzojnë Sekretarisë një përgjigje ndaj kërkesës brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e një kopje të kërkesës nga Sekretaria.

6. Palët me interes, të njoftuara, cilët nuk e informojnë Sekretarinë për qëllimin e tyre për të marrë pjesë në procedurë brenda afateve të përshkruara në këtë nen, konsiderohet se kanë hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në procedurë.

7. Sekretaria ka kompetenca të hedhë poshtë kërkesat që me arsye janë të papranueshme dhe që nuk janë në kuadër të kompetencave të AKKVP-së në pajtim me këtë nen.

8. Parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të kundërshtojë vendimin e Sekretarisë për hedhjen poshtë të kërkesës në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në raste të tilla, Sekretaria do ta referojë kërkesën në KKP për një vendim.

Neni 8

Neni 12 i ligjit bazik, pas nënparagrafit 4.3, shtohet një nënparagrafi i ri 4.4, me tekstin si në vijim:

4.4. Kërkesat për njohje ligjore të të drejtave joformale pronësore, të cilat janë të natyrës kontestimore, hidhen poshtë dhe KKP-ja udhëzon palët në gjykatën themelore kompetente.

Neni 9

Neni 13 i ligjit bazik paragrafi 2, pas tekstit "**Me marrjen e të dhënave kadastrale**" shtohet teksti "**nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Zyrat Kadastrale Komunale**".

Neni 10

Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 8 ndryshohet si vijon:

8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos për ankesat në një panel prej tre (3) gjyqtarësh. Përbërja e panelit do të pasqyrojë përbërjen etnike në përputhje me Ligjin përkatës për Gjykatat.

Neni 11

Neni 16 i ligjit bazik, nënparagrafët 3.1 dhe 3.2. riformulohen me tekstin si në vijim:

3.1. E pranon ankesën dhe merr vendim për ndryshimin apo rishqyrtimin e vendimit të Komisioneve përkatëse të AKKVP-së;

3.2. E hedh poshtë ankesën si të papranueshme për arsye procedurale; ose

Neni 12

Neni 18 i ligjit bazik, paragrafët 1 dhe 2 riformulohen, ndërsa shtohet një paragraf i ri 3 me tekstin si në vijim:

1. Mjetet juridike për ekzekutimin e vendimit mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në dëbimin, vendosjen e pronës nën administrim, marrëveshjen për qiradhënie, shkatërrimin e strukturave të paligjshme dhe kërkesën për regjistrimin në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme.

2. Para shfrytëzimit të mjetit juridik për shkatërrimin e strukturave të paligjshme, palët, në rast të pajtimit, mund të shfrytëzojnë ndërmjetësimin në qëllim të arritjes së marrëveshjes miqësore ndërmjet tyre.

3. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e mjeteve juridike do të përcaktohen përmes akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria me propozimin e AKKVP-së.

Neni 13

Neni 19 i ligjit bazik, paragrafët 6 dhe 7 do të zëvendësohen me paragrafin 6, me tekstin si në vijim:

6. Nëse prona riuzurpohet pas ekzekutimit të dëbimit, dhe pas njoftimit nga parashtuesi i kërkesës për riuzurpimin e kundërligjshëm të pronës, AKKVP do ta ridëbojë uzurpuesin nga prona bazuar në urdhëresën e re të lëshuar, duke i respektuar procedurat e këtij ligji.

6.1. Procedurat e ridëbimit do të zbatohen nga AKKVP, për aq herë sa uzurpohet prona, gjithnjë mbi bazën e njoftimit nga parashtuesi i kërkesës për riuzurpimin e pronës.

6.2. Brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) muajve nga kryerja e dëbimit të parë dhe nëse parashtuesi i kërkesës nuk njofton se prona është riuzurpuar, kërkesa do të mbyllet administrativisht. Vetëm në rast të njoftimit për riuzurpim kërkesa e tillë do të rihapet.

6.3. Pas dëbimit të uzurpatorit nga prona AKKVP lëshon protokollin mbi pranidorëzimin e çelësave ose dëftesën riposeduese si dëshmi mbi ri posedimin e pronës.

6.4. Gjatë periudhave kur prona gjendet e uzurpuar, gjatë procesit të dëbimit si dhe pas përfundimit të procesit të dëbimit, AKKVP nuk mban përgjegjësi dhe obligime për dëmtimin e pronës apo humbjen eventuale të gjësendeve që mund të ndodhin në pronë.

6.5. AKKVP ushtron kallëzim penal ndaj riuzurpatorit të pronës, pranë organeve kompetente, për vepër penale, konform Kodit Penal të Kosovës.

6.6. Procedura e dëbimit e zbatuar sipas paragrafëve më lartë do të aplikohet vetëm për rastet e dëbimit dhe rastet të cilat janë në proces të dëbimit, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 14

Neni 20 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 20

Regjistrimi i vendimeve të KVVP-së dhe KKP-së në regjistrat kadastral

Vendimi i plotfuqishëm i KVVP-së dhe i KKP-së për njohje ligjore të të drejtave jo formale pronësore, apo Vendimi sipas ankesës i nxjerrur nga Gjykata Supreme e Kosovës, u dërgohet palëve dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës nga Sekretaria. Agjencia Kadastrale e Kosovës përditëson të dhënat kadastrale bazuar në këto vendime përfundimtare. Në këtë aspekt shpenzimet paguhen vetëm nga bartësi i të drejtës pronësore/pronari me rastin e lëshimit të të dhënave kadastrale të përditësuara.

Neni 15

Neni 21 i ligjit bazik, paragrafët 7 dhe 8 fshihen dhe zëvendësohen me paragrafët 7, 8, 9 dhe 10, me tekstin si në vijim:

7. AKKVP do të vazhdojë me administrimin e pronave dhe zbatimin e skemës së qirasë, mbi bazën e këtij ligji.

8. AKKVP do të vazhdojë me administrimin deri në kohën kur Qeveria e Kosovës, mbi bazën e raportit të AKKVP-së, i propozon Kuvendit për ndërprerjen e administrimit dhe zbatimit të skemës së qirasë.

9. Administrimi mund të vazhdohet vetëm nëse, bazuar në rrethana, ekziston nevoja e mbrojtjes së të drejtës pronësore në këtë mënyrë.

10. Rregullat dhe procedurat e administrimit të pronave do të përcaktohen me një akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozimin e AKKVP-së.

Neni 16

Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 5, riformulohet me tekstin si në vijim:

5. AKKVP trashëgon përgjegjësitë e Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore në lidhje me zbatimin e vendimeve mbi kthimin e të drejtave të banimit për banesat shoqërore të humbura si rezultat i diskriminimit, të cilat do të zbatohen në pajtim me kriteret dhe procedurat e miratuara nga Qeveria e Kosovës, përmes aktit nënligjor.

Neni 17

Neni 25 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 25

Kërkesat e parashtruara pranë gjykatave

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për çdo kërkesë nga nënparagrafi 2.2 i nenit 4 të këtij ligji, që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, me kusht që procedura gjyqësore lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para themelimit të AKKVP-së.

2. Ky nen nuk i cenon të drejtat e parashtruesve të kërkesave që të ushtrojnë pranë gjykatave kompetente, kërkesat që nuk përfshihen në kërkesat e paraqitura në nënparagrafin 2.2. të nenit 4 i këtij ligji dhe ato që nuk janë paraqitur brenda afatit për paraqitjen e kërkesave.

Neni 18

Neni 30 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 30

Zbatimi

Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e AKKVP-së, brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet tjera nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 19

1. Në të gjithë tekstin e ligjit bazik, fjala “**dallim**”, zëvendësohet me fjalën “**zbrazëti**”.

2. Në të gjithë tekstin e ligjit bazik, fjala “**mospajtueshmëri**”, zëvendësohet me fjalën “**mospërputhshmëri**”.

3. Në të gjithë tekstin e ligjit bazik, togfjalëshi “**pronën private të bashkësive fetare**”, zëvendësohet me “**pronën e bashkësive fetare**”.

Neni 20

Mjetet e ndara për zbatimin e skemës së kompenzimit në lidhje me njëqind e dyzet e tri (143) rastet e vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, do të mbahen në llogari të mirëbesimit të hapur për këtë qëllim deri në zbatimin e këtyre vendimeve.

Neni 21

Në të gjithë tekstin e ligjit bazik, “**Ligji Nr. 04/L -274**”, zëvendësohet me “**Ligjin në fuqi për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare**”.

Neni 22

Me këtë Ligj shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2017 për Procedurat Kushtet dhe Kriteret rreth përfundimit të Administrimit të Pronave nën Administrimin dhe atyre të përfshira në Skemën e Qirasë së AKKVP-së dhe çdo dispozitë e akteve tjera nënligjore që është në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-052
23 dhjetor 2022

Shpallur me dekretin Nr. DL-02/2023, datë 06.01.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu